



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:002370

Datë: 12.04.2024

Numri i dokumentit: 05575034

KF.nr.330/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Tihovci” N.T. me numër unik identifikues 810438102 me seli në Prishtinë, rr. “Zona Industriale”, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, vlerësim tatimor, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor- publik me datë 03.04.2024, të mbajtur në prani të pronarit të biznesit R.I. dhe kontabilistit S.Z., e në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “Tihovci” N.T. me numër unik identifikues 810438102 me seli në Prishtinë, rr. “Zona Industriale”, si e pabazuar.
- II. Mbetet në fuqi Vendimi nr.273/2020 i datës 02.12.2020 i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 08.01.2021, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr.273/2020 të datës 02.12.2020, me të cilin është aprovuar pjesërisht ankesa e paditësit

kundër Raport të kontrollit, ndërsa ka mbet në fuqi pjesa kontestuese me të cilën paditësi ngarkohet me tatim shtesë për periudhën 4/2015 dhe 1/2016 qarkullim shtesë në TVSH dhe në deklaratën vjetore në periudhën 12/2016 në PD. Paditësi si në padi dhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor të datës 03.04.2024, ka theksuar se qëndrojnë në tërësi pranë padisë së paraqitur kundër vendimit kontestues lidhur me pikën e vetme të cilat huazimet i ka trajtuar si qarkullime shtesë dhe atë: qarkullimi shtesë me datën 10.04.2015 me vlerë prej 8,500.00 euro i cili është kryer përmes llogarisë bankare për të cilën posedojnë kontratën e huazimit e cila është pjesë e dosjes dhe e qarkullimit dhe huazimi në vlerë prej 30,000.00 euro e datës 19.01.2016 nga N.S. mjetet të cilat i janë dhënë kesh dhe të njëjtit i kanë deponuar në llogarinë bankare. Shton se pjesë e dosjes është edhe kontrata e huazimit dhe fletë deponimi bankar. Paditësi tutje deklaron se lidhur me huazimin prej 30,000.00 euro i cili ka ndodhur në janar të vitit 2016 me Udhëzim Administrativ nuk ka qenë e paraparë se huazimet në kesh janë të ndaluara. Me UA të nxjerrë në mars të vitit të njëjtë është rregulluar kjo çështje, mirëpo i njëjti në raport me paditësin është shfrytëzuar në mënyrë retroaktive. Në fjalën përfundimtare gjykatës i ka kërkuar të anulohet vendimi kontestues, të lirohet paditësi nga qarkullimi shtesë në vlerë prej 8,500.00 euro për periudhën prill 2015 dhe të lirohet nga qarkullimi shtesë në vlerë prej 30,000.00 euro për periudhën janar 2016.

E paditura, në përgjigje në padi të datës 08.04.2022 ka deklaruar se vendimi i DA-së nr.273/2020 është i drejtë dhe në pajtim me dispozitat e legjislacionit tatimor në fuqi. Ka shtuar se ATK- DA-ja ka shqyrtuar të gjitha provat që ka disponuar dhe bazuar në dispozitat e legjislacionit tatimor ka konstatuar se tatimpaguesi tani paditësi mbetet obligues i tatimit për pikat kontestuese të padisë. Tutje ka shtuar se lidhur me pikën e parë kontestuese të paditësit për kthimin e huazimit nga M.J., ATK-DA ka vlerësuar se bazuar në llogarinë bankare të biznesit në NLB vërehet se me datë 10.04.2015 është transferuar në kuadër të bankës nga M.J. vlera prej 8,500.00 € tek biznesi "Tihovci" me përshkrimin si kthim huazimi nga M.J. për NT."Tihovci" dhe e njëjta vlere prej 8,500.00€ nuk vërehet se është kthyer për M.J.n nga biznesi "Tihovci", pavarësisht përshkrimit në llogarinë bankare si huazim. Ka sqaruar se Departamenti i Ankesave, bazuar në lëvizjet bankare sipas llogarisë bankare të biznesit ku është kredituar vlera prej 8,500.00€ me datë 10.04.2015 me përshkrimin kthim i huazimit nga M.J. për NT "Tihovci" një arsytim i tillë nuk qëndron dhe paditësi mbetet obligues i tatimit për periudhën 04/2015 në TVSH-ë në vlere prej 7,327.59 €. Tutje ka shtuar se po ashtu edhe me huazimin e datës 19.01.2016 bazuar në llogarinë bankare të biznesit në NLB në

përshkrimin huazim nga N.S.-deponim M.J. NT. “Tihovci”, konstatohet se tatimpaguesi vlerën prej 30,000.00 € vetë e ka deponuar në llogari bankare dhe se kjo vlere asnjëherë nuk i është kthyer huadhënësit në periudhën e kontrollit ashtu siç pretendon tatimpaguesi në DA. Andaj, bazuar në dispozitat e legjislacionit tatimor gjegjësisht nenit 19 paragrafi 1.1.3 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2016 për zbatim e ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, paditësi nuk i plotëson kushtet për ta trajtuar këtë deponim si huazim për qëllime tatimore. Ndërsa, me parashtrësën e datës 02.04.2024, gjykatën e ka njoftuar se nuk do të prezantoj në seancën e shqyrtimit gjyqësor me kërkesë që gjykata të vepron në pajtim me nenin 38 par 5 të LKA-së, ndërsa lidhur me padinë e paditësit, gjykatës i ka propozuar që të refuzohet dhe të mbetet në fuqi vendimi nr.273/2020.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 03.04.2024, ka administruar provat si në vijim: Vendimi 273/2020 i datës 02.12.2020, Marrëveshje mbi huazimin e datës 19.01.2016, Transferi bankar i datës 19.01.2016, Transfer bankar i datës 10.04.2015, Raport i kontrollit i datës 27.11.2020, Vendimi 273/2020 i datës 14.10.2020, Detajet e vlerësimit printuar me datë 12.02.2020, Formular i deklarimit vjetor periudha 2018, Certifikata e mbajtjes në burim të tatim të interesit 10.04.2019, Gjendja e përgjithshme e tatim paguesit e datës 01.04.2020, Ankesë e datës 24.08.2020, Borxhi i falur printuar me datë 28.03.2020.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ, Raporti i Kontrollit, deklarimeve në padi, shkresave të lëndës, vendimit kontestues, përgjigjës në padi, gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se kontrolli tek subjekti në procedurë është realizuar me datë 12.08.2020, për periudhën kontrolluese 2015-2018 për llojet e tatimit, TVSH, PD, CI, WM, CM WR, e si rezultat i të cilit edhe janë konstatuar ndryshime për secilin vit të kontrollit për llojet e

tatimeve si më lartë e ku nga rezultatet përfundimtare ka dalë tatim shtesë Qarkullimi shtesë 73,126.16 euro, ulje kreditimi 6,651.62 euro, Tatim shtesë në TVSH 9,791.74 euro, ndëshkime administrative 2,447.94 euro, tatim shtesë në PD dhe TAP 8,242.77 euro dhe ndëshkim administrativ 2,060.69 euro. Po ashtu, nuk është kontestuese as fakti se subjekti në procedurë ka ushtruar ankesë me datën 24.08.2020, në Divizionin e Ankesave të ATK-së, e cila edhe ka marrë vendimin me nr.prot.273/2020 të datës 14.10.2020, me të cilën ishte suspenduar përkohësisht shqyrtimi i lëndës. Me datë 27.11.2020 e paditura ka nxjerr raportin e kontrollit/sqarime shtesë, pas të cilit edhe ishte vendosur lidhur me ankesën e paditësit, vendimi i të cilës si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë me të cilin ka është aprovuar pjesërisht ankesa duke e liruar paditësin nga tatimet shtesë për Tatimin e Vlerës së Shtuar për periudhën 01/2015, 07/2015, 08/2015, 10/2015, 10/2016, 01/2017 dhe 12/2018 dhe tatimi në të ardhura personale 2015, 2016, 2017 dhe 2018, ndërsa në pikën III ka vendosur se ngarkohet me tatim shtesë (WR) në interes për periudhën 2015-2018, e kundër të cilit akt administrativ, paditësi me padinë e datës 08.01.2021, ka iniciuar këtë kontest tregtar - administrativ pranë kësaj gjykate. Kontestuese në mes të palëve mbetet nëse huazimet kontestuese duhet liruar nga qarkullimi shtesë.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Divizioni i Ankesave - të ATK-së, e ka refuzuar ankesën e subjektit tatimor, këtu paditësit me arsyetim si në vendimin kontestues, ku lidhur me mosnjohjen e huazimit në vlerë prej 8.500.00 euro, ka sqaruar se nuk qëndron arsyetimi i tatimpaguesit si në përshkrim me sqarime në DA dhe qarkullimi shtesë me tatim shtesë mbetet pa ndryshime si në Raportin e Kontrollit paraprak për periudhën mujore: 04/2015 në TVSH për vlerën prej 7,327.59 euro – vlera e tatueshme, ndërsa lidhur me vlerën prej 30,000.00 euro ka sqaruar se sipas nenit 19 par 1.1.3 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2016 për zbatimin e Ligjit nr.05/L-058 për tatimin në të ardhura personale, tatimpaguesi nuk i plotëson kushtet ligjore për të trajtuar këtë deponim si Huazim për qëllime tatimore për shkak se tatimpaguesi i ka deponuar vetë në bankë vlerën prej 30,000.00 euro, përshkrimin si në llogari bankare të biznesit dhe për këtë arsye nuk i është pranuar arsyetimi dhe është ngarkuar me qarkullim shtesë me kontroll në periudhën tatimore 01/2016 në TVSH dhe në deklaratën vjetore në periudhën 12/2016 në PD, dhe qarkullimi shtesë me tatim shtesë mbetet (pa ndryshime) si në Raportin e Kontrollit paraprak për periudhën mujore 01/2016 në TVSH për vlerën prej 25,423.73 € - Vlera e tatueshme.

Gjykata ka gjetur se provat e prezantuara si tek organi administrativ ashtu edhe në gjykatë, nuk i plotësojnë kriteret për ti pranuar si të rregullta për qëllime tatimore, andaj edhe e paditura me të drejtë nuk e ka marrë për bazë pretendimet e paditësit kur ka vendosur për tatimet shtesë si të cekur më lart. Gjykata lidhur me deponimin si huazim në vlerë prej 30,000.00 euro dhe deklarimin e kthimit të huazimit në vlerë prej 8,500.00 euro i ka pranuar të gjeturat e ATK-së, ngase të njëjtat nuk korrespondojnë me ndonjë të dhënë siç edhe ka arsyetuar e paditura se nuk ka dëshmi se këto huazime janë kthyer për tu njohur dhe pranuar nga e paditura për qëllime tatimore.

Gjykata pranon vlerësimin e të paditurës se paditësi sipas nenit 19 paragrafi 1.1.3 të UA 01/2016 për zbatimin e ligjit nr.05/L-028 për tatimi në të ardhura personale, nuk i plotëson kushtet ligjore për të trajtuar këtë deponim si huazim për qëllime tatimore. Nga kontrata e parashtruar si provë, me nenin 1.1 është paraparë se kthimi i këtyre të hollave bëhet në afat prej 31.12.2016, mirëpo paditësi nuk ka ofruar prova për të dëshmuar se këto mjete janë kthyer huadhënësit, po ashtu lidhur me transferin bankar me përshkrim “*kthim huazimi nga M.J. për NT Tihovci*”, pretendimin e paditësit se kur është transferuar huazimi nga M.J. me të cilin kanë pasur edhe më herët huazime nga i njëjti në transfer është përshkruar si kthim huazimi, ndërsa është dashur që përshkrimi të jetë huazim, gjykata e gjeti të paqëndrueshëm në mungesë të provave të cilat do ta argumentonin të kundërtën. Paditësi nuk ka ofruar kontratë huazimi për këtë shumë, po ashtu nuk ka ofruar as dëshmi se ky huazim është kthyer siç edhe kishte ofruar për huazimet tjera e të cilat e paditura i ka pranuar dhe paditësin e ka liruar nga qarkullimet shtesë.

Gjykata, pretendimin e paditësit se lidhur me huazimin prej 30,000.00 euro i cili ka ndodhur në janar të vitit 2016 me Udhëzim Administrativ nuk ka qenë e paraparë se huazimet në kesh janë të ndaluara, dhe se me UA të nxjerrë në mars të vitit të njëjtë është rregulluar kjo çështje, mirëpo i njëjti në raport me neve është shfrytëzuar në mënyrë retroaktive, e vlerësoi si të paqëndrueshëm, kjo për faktin se paditësi edhe pse nuk e ka pasur për detyrim pranimin e huadhënies me transfer bankar, nuk ka dëshmuar se kur është kthyer ky huazim, nëse është kthyer siç është kontraktuar deri në fund të dhjetorit të vitit 2016, atëherë kthimi sipas UA 01/2016 është dashtë të realizohet me transfer bankar, apo edhe nëse nuk është realizuar me transfer bankar nuk ka dëshmuar kthimin, qoftë me ndonjë tërheqje e cila do të arsyetonte se e njëjta është realizuar me qëllim të kthimit të huamarrjes.

Bazuar në faktin se gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar - administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative konform nenit 43 paragrafi 1, të LKA-se, nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga ana e organit të paditur, kjo për faktin se paditësi në këtë kontest tregtar-administrativ ka dështuar që të prezantojë provat me të cilat do të mbështeste pretendimet e tija në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para Gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij.

Gjykata, vlerësoi edhe pretendimin e paditësit se aktvendimi i kontestuar nuk e ka konstatuar drejtë gjendjen faktike, prandaj si i tillë kërkon që të anulohet, mirëpo i njëjti rezulton të jetë i pabazuar meqë përveç të theksuarit në padi pretendimin e tillë nuk e ka argumentuar me asnjë provë të vetme materiale ashtu siç edhe përcaktohet sipas nenit 7, par 1, dhe 3, të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK) me të cilin përcaktohet se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla,”* dhe me nenin 319 të LPK-së me të cilin përcaktohet se *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”* e gjithashtu edhe me nenin 38 të LKA-së është përcaktuar se Gjykata vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve. Pala paditëse duhet të parashtrij faktet, në të cilat mbështetet kërkesa e saj. Andaj, barra për paraqitjen e fakteve dhe provave në një proces gjyqësor u takon palëve.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë. Gjykata konstaton se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj pretendimet e paditësit nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organit të paditur.

Gjykata vlerëson se vendimi nr. 273/2020 i datës 02.12.2020 i të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës-Divizioni i Ankesave, me të cilin është refuzuar si e pa bazuar ankesa e subjektit në procedurë, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimin për shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 64 të LKA-së.

Na të cekurat më lart, Gjykata konform dispozitave ligjore të neni 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal  
KF.nr.330/22, datë 03.04.2024

Gjyqtarja  
Vera Gashi Bala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.